



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR SH.A

Nr. _____ Prot.

Bulqizë, më ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – SHËRBIME”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Supervizion punimesh për objektin: “Ndërtimi Rrjeti shpërndarës në fshatrat Cerenc i sipërm dhe Cerenc i poshtëm dhe ndërtim depo uji”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

71247000-1 Mbikëqyrja e punës së ndërtimit.

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,558,160 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH** nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2024 në vlerën: 374,586.67 (treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për vitin 2025 në vlerën: 561,880 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2026 në vlerën: 621,693.33 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c, nenit 11, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër Sh.A.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/ Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 9).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 10 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare

dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..”

2. **Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme**

3. **Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, vlerë kjo e kërkuar brenda masës së përcaktuar në dispozitat nënligjore të sipërcituara, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Krahas dokumentacionit të mësipërm të paraqitet situacioni i punimeve të ndërtimit i konfirmuar nga Autoriteti Kontraktor/Investitori për të cilin është kryer shërbimi i ngjashëm i mbikqyrjes për kontratën e paraqitur në procedurë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 3 dhe 6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ndërsa në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas

këtij neni, Njësia vlerëson se krahas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 41 të VKM-së, referuar rëndësisë që ka investimi për të cilin kërkohet shërbimi i mbikqyerjes, me qëllim vërtetimin e përvojës së mëparshme në kryerjen e shërbimeve të ngjashme të operatorëve ekonomik, njësia e prokurimit vlerëson se duhet kërkuar dhe dokumentacioni ligjor shtesë si, situacioni i punimeve të ndërtimit të investimit për të cilin është kryer shërbimi i mbikqyerjes dhe është paraqitur dokumentacioni në këtë procedurë, gjë e cila nuk sjell kosto shtesë për operatorët ekonomik (*disponohet si dokument nga ana e tyre*), përkundrazi ndihmon në vlerësimin e drejtë të përmbushjes së qëllimit që ka ky kusht ligjor.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale të shoqërisë për mbikqyerje të punimeve të zbatimit në ndërtim, si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për mbikqyerjen e punimeve të zbatimit objekt i kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.759, datë 12.11.2014 “*Për liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyerjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” (i ndryshuar). Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë në fushën e mbikqyerjes së punimeve të përgjithshme dhe speciale të ndërtimit të mëposhtme:

- **Kategoria NP-1** (*Punime gjurmimi në tokë*)
- **Kategoria NP-2** (*Ndërtime civile dhe industriale*)
- **Kategoria NP-7** (*Ujësjetësia, gazsjellsa, vajsjetësia, vepra kullimi e vaditje*)
- **Kategoria NP-12** (*Punime të inxhinierisë së mjedisit*)
- **Kategoria NS-4** (*Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese*)
- **Kategoria NS-8** (*Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri*)
- **Kategoria NS-18** (*Punime topogjeodezike*)

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë përkatëse në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, liçensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër shërbimet për të cilat kërkohet liçensa profesionale.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik¹*” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) **përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale**;... c) **aftësinë teknike dhe profesionale**;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin

kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se, referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve të investimit për të cilin kërkohet shërbimi i mbikqyrjes objekt kontrate, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 610, datë 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 759, datë 12.11.2014 “Për liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (i ndryshuar), pika 1 dhe 16 e tij, në të cilën përcaktohet se, citojmë: “1. Çdo individ apo subjekt juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse sipas përcaktimeve të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale, bashkëlidhur këtij vendimi... 16/1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.”, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë liçensën profesionale për mbikqyrjen e punimeve, si dhe kategoritë e kërkuara të përcaktuara në përputhje me natyrën e punimeve objekt investimi për të cilin kërkohet shërbimi i mbikqyrjes së punimeve, të cilat janë: kategorinë NP-1 (Punime gjurmimi në tokë) në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (Gërmim toke për nivelim me eskavator..., Gërmim me krah në seksion të detyruar..., Gërmim dheu me eskavator goma..., Gërmim kanali... etj); **Kategoria NP-2 (Ndërtime civile dhe industriale)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për ndërtimin e depos 50 m² për fshatin Cereneç i Poshtëm dh rikonstruksionin e depos 50 m² për fshatin Cereneç i Sipërm; **kategorinë NP-7 (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për ndërtimin e ujësjellësit (F.V. Tuba e rakorderi ujësjellësi..., F.V. Tuba çeliku..., F.V. Manikota, Fllanxe etj.); **kategorinë NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit)** duke qënë se kjo vepër po zhvillohet në terren të pyllëzuar, ka të bëjë me ruajtjen dhe eliminimin e prishjes së ekuilibrave ekologjike në terrenin ku do të kryhen punimet objekt prokurimi si nga procesi i kryerjes së punimeve ashtu dhe mbetjeve inerte; **Kategoria NS-4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës****

teknike ndërtuese) në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Punime betoni e hekuri, beton, shtresa pllaka/ mermer, suvatime, porta, punime për patinim, bojatisje etj.*); **Kategoria NS-8** (*Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura...*) në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Struktura monolite betoni...*); **kategorinë NS-18** (*Punime topogjeodezike*) - duke qënë se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike, është e nevojshme zotërimi dhe i kësaj pike liçense, **kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.**

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO 14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **ISO 45001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose **ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a, 2 dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 5/c dhe 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:... c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së shërbimit objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të kryhen (ato të mbikqyerjes së punimeve ndërtimore), njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto shërbime (ISO 9001), dhe të sistemit të menaxhimit të mjedisit (ka të bëjë me aftësinë e operatorëve ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi) (ISO 14001), si dhe për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (ka të bëjë me aftësinë e operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor) (ISO 45001).

Njësia e prokurimit përcaktoj kërkesën si më lart, duke qënë se është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, por edhe sepse mbi të gjitha i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre (besueshmërinë) për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **5 (pesë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihet edhe stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 10 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- **Drejtuesin e punimeve dhe Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë** që duhet të jetë **inxhinier Hidroteknik** ose **Ndërtimi** me liçence profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek dhe miraton cilësinë e produkteve, korrespondencën me AKUK, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit;
- **Inxhinier Topograf**, i cili duhet të jetë i pajisur me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton piketimet dhe kuotëzimin e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit;
- **Inxhinier Ndërtimi**, i cili duhet të jetë i pajisur me liçence profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit;
- **Inxhinier Hidroteknik**, i cili duhet të jetë i pajisur me liçence profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit
- **Inxhinieri Mjedisi** i cili duhet të jetë i pajisur me liçence profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton venddepozitimet e gërmimeve, planin e menaxhimit mjedisor, dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

* Disponimi i stafit teknik (inxhinierëve) të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit*, për secilin inxhinier, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë noteriale pune (të vlefshme), liçencë profesionale për mbikëqyerje, diplomë përkatëse, CV, Çertifikatën për kontrollin dhe sigurinë e cilësisë sipas ISO 9001: 2015 për drejtuesin e punimeve, si dhe të figurojnë detyrimisht të punësuar me kohë të plotë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1 dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për

të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. **4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4/b dhe c të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: **“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...**

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e numërit minimal prej **5 (pesë) punonjës**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 41 pika 4/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e stafit teknik të inxhinierëve që nevojitet për realizimin e shërbimit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 7 “*Termet e Referencës*” dhe llojit të punimeve që do të kryhen, për të cilat kërkohet shërbimi i mbikqyrjes së tyre, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të**

nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

2. Me qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij, njësia e prokurimit referuar natyrës së punimeve për të cilat kërkohet shërbimi i mbikqyrjes objekt kontrate, vlerëson se, **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes së punimeve.** Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht, është kërkuar: Drejtuesin e punimeve dhe Mbikqyrësin e materialeve dhe cilësisë – në lidhje me mbikqyerjen e zbatimit të projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikaten e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek dhe miraton cilësinë e produkteve, korrespondencën me AKUK, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt; Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder, pasi do të kryejë mbikqyerjen e *azhornimeve topografike, piketimeve të mureve mbrojtëse, si dhe kontrollin e zbatimit kuotave sipas projektit; Inxhinier Ndërtimi*, në lidhje me mbikqyerjen e punimeve ndërtimore të gërmimit, mbushje me materiale dheu e inerte, struktura monolite betoni, etj., ku është e nevojshme ndjekja e punimeve edhe nga inxhinieri e ndërtimit; Inxhinier Hidroteknik, në lidhje me mbikqyerjen e punimeve të ndërtimit e linjave të furnizimit dhe ato të shpërndarjes me ujë të pijshëm në banesa ku është e nevojshme që punimet të kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit me profilin e duhur, si dhe 1 (një) Inxhinier Mjedisi, pasi duke qënë se punimet do të kryhen në mjedis të pasur me drurë, shkurre etj., ku do të hapet traseja e tubit, nëpërmjet gërmime në thellësi të tokës, lind e domosdoeshme disponimi i këtij inxhinieri, i cili kontrollon dhe miraton venddepozitimet e gërmimeve, planin e menaxhimit mjedisor, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” (i ndryshuar), dhe me qëllim vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Stafi teknik (inxhinierët) i kualifikuar i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”, si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”. **Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, dhe/ ose në rast se vlera e ofertuar është nën vlerën minimale të lejuar në VKM-në Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.**

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 80** pika **2** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, **nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.**”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika **5/ç** dhe **6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: ... ç) **operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.**

Në **nenin 7** “Përcaktimi i tarifave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **354, datë 11.05.2016** “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyerje dhe kolaudim” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**1. Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik.**”

Në shkresën **Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017** “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” të Agjensisë së Prokurimit Publik, drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë, APP-ja ndër të tjerash rekomandon se, citojmë: “**3. Në paraqitjen e ofertave në këtë lloj procedure prokurimi, operatorët ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë edhe vlerat minimale të përllogaritura nga autoritetet kontraktore në zbatim të VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”.**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, dhe rekomandimit të APP-së, autoriteti kontraktor vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin vlerën e ofertës së tyre për shërbimin që kërkohet në përputhje me përcaktimet e Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim*”, dhe se tarifa e shërbimit duhet të përlogaritet sipas kategorisë dhe grupit tarifor ku bën pjesë objekti i prokurimit, ku për këtë qëllim duhet të paraqesin dhe Analizën e përlogaritjes së ofertës sipas VKM-së Nr. 354, datë 11.05.2016, mbi mënyrën se si është llogaritur vlera e ofertuar nga ana e tyre, pasi në rast të kundërt, do të procedohet me s’kualifikimin e ofertave të tyre.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin e mësipërm pasi oferta e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të jetë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij të mbikqyrjes së punimeve, në zbatim të nenit 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “*Për Prokurimin publik¹*”, dhe nenit 15 pika 3 gërma “c”, e nenit 41 pika 1 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar), ligjit **Nr.8402, datë 10.09.1998** “*Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave **Nr. 610, datë 22.09.2022** “*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*”, dhe Udhëzimi **Nr.2, datë 13.05.2005** “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, njësia e prokurimit kreu hartimin dhe miratimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për shërbimin e secilit lot objekt prokurimi, si më poshtë:

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë, i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërkohet nga investitori.

Vlera e investimeve është:

I. Objekti i investimit: **“Ndërtim Rrjeti shpërndarës në fshatrat Cerenec i sipërm dhe Cerenec i poshtëm dhe ndërtim depo uji”**, me fond limit në vlerën: **67,192,382** (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**.

1. Objektivi kryesor i Mbikqyrësit

1.1 Mbikqyrësi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarevajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

2. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyrësit

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Kontraktor dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislacionit në fuqi.
- Të njihet në detaj me projekt - zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve.
- Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor stafin e tij mbikqyrës, siç është përcaktuar në kërkesat e stafit kryesor.
- Në bazë të volumit të punimeve dhe vlerës së kontratës Mbikqyrësi i punimeve duhet të jetë rezident me kohë pune të plotë në objekt, ndërsa stafi tjetër mbikqyrës mund të jetë rezident në objekt me kohë të pjesshme.

2.2 Mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin, etj.

2.3 Mbikqyrësi vë në dijeni Autoritetin Kontraktor për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh Sipërmarrësi (*Zbatuesi i Punimeve*) në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve, kur kjo është e lejuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit objekt investimi.

2.4 Mbikqyrësi në fillim të punimeve në objekt, merr kontakt me organet qeverisëse, në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin/ rehabilitimin e objektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi (*neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998, i ndryshuar*).

3 Detyrat e mbikqyrësit

3.1 Mbikqyrësi ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës të liçensave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe gati për të filluar punimet.

- Të njihet me hollësi me kontratën e zbatimit të punimeve dhe të gjithë akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit me të dhënat e mëposhtme:
 - *Emërtimi i objektit:*
 - *Data e marrjes së lejes së ndërtimit:*
 - *Investitori:*
 - *Projektuesi:*
 - *Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik:*
 - *Mbikqyrësi:*
 - *Afati i ndërtimit të objektit:*
 - *Vlera e objektit:*

3.2 Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese e të sigurisë, shiritave, fenerëve, etj.
- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin, si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku të përfshihen:
 - Stafi i sipërmarrësit
 - Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit
 - Pikat e marrjes së lëndëve të para
 - Zonat e ngritjes së kantjerit
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e Sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së zbatimit.
- Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specififikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet, nëse ka, dhe t'i propozojë Autoritetit Kontraktor zgjidhjet konkrete.
- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të kontratave.
- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
- Për çdo punim të maskuar të bëjë (fotografimin ose regjistrim e tij) dhe të mbajë proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit.
- Në çdo fund dite pune të kontrollojë ditarin e punimeve dhe të firmosë atë.
- Të kontrollojë librezën e masave, e cila vërteton volumin e punimeve dhe ta miratojë atë.
- Të kontrollojë certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen e tyre në objekt.
- Gjatë zbatimit të projektit, i jep udhëzime me shkrim sipërmarrësit, sa herë që e shih të nevojshme dhe Sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit, ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me udhëzimet dhe urdhërat e marra.

- Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyrësi i punimeve duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor një relacion të plotë teknik, shoqëruar me skicat përkatëse ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt, gjatë zbatimit të punimeve, do të bëhet vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor.
- Në çdo fund muaji, Mbikqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e progresit të punimeve dhe të pagesave të kryera, realizimi i punimeve në vlerë dhe %, afati kohor, realizimi i financimit.
- Korrespondenca ndërmjet palëve bëhet gjithnjë në mënyrë zyrtare, me shkrim.

3.3 Raporti Mujor do të përmbajë lëndën e mëposhtme:

- Hyrje
- Informacion i përgjithshëm
 - *Të përgjithshme*
 - *Qëllimi i punimeve*
 - *Mbikqyrja e punimeve ndërtimore*
- Personeli i siguar nga Mbikqyrësi
 - *Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve*
 - *Stafi aktual*
 - *Kohëqëndrimi në objekt për secilin pjesëtar të stafit mbikqyrës*
- Raportimi
- Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes
- Përshkrimi i Projektit
 - *Karakteristikat teknike dhe të dhëna për objektin specifik*
- Organizimi i Sipërmarrësit
 - *Sipërmarrësi*
 - *Stafi prezent*
 - *Mjete dhe makineri*
 - *Kohëqëndrimi në objekt*
- Progresi Mujor
- Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)
- Fotografi të proceseve të punimeve të kryera
- Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm
- Grafiku i ecurisë së punimeve
 - *Të aprovuara*
 - *Të kryera*
- Volumet Progressive të Punimeve Mujore
 - *Punimet e Aprovuara*
 - *Çertifikatat e cilësisë dhe Provat Laboratorike*
 - *Libreza e Masave*
 - *Punimet e Kryera por të pa aprovuara*
 - *Situacionet mujore*
 - *Matjet topografike*

- Korrespondenca
 - *Proces-Verbale*
 - *Urdhëra, Udhëzime, Njoftime*
 - *Ndryshime në Projekt - Preventiv nëse ka (të aprovuara nga Autoriteti Kontraktor)*
- Moti (kalendarik)
- Problemet që kanë dalë
 - *Teknike*
 - *Sociale*
- Konkluzione

4. Përgjegjësitë e Mbikqyrësit

4.1 Në fillim të punimeve Mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vendimin e sheshit të ndërtimit dhe lejen origjinale zhvillimore (nëse ka).
- Projekt - zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet.
- Dokumentacionin për realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
- Për realizimin me korrektësi të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe Autoritetit Kontraktor, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyrësit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë Mbikqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korrespondencën me Autoritetin Kontraktor, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.
- Në rast se gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të Mbikqyrësit, për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon Mbikqyrësi, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces-verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

5. Të drejtat e Mbikqyrësit

5.1 Mbikqyrësi ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të Drejtuesit të Kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, etj, nqs këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- Të pezulloje punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
- Të kërkojë çertifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materiale.

- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Sipërmarrësit.
- Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore.
- Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme nqs ato janë jashtë kushteve teknike.
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga Mbikqyrësi këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave, se bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara referuar standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit.
- Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Sipërmarrësit.
- Kur Mbikqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë Mbikqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të Sipërmarrësit. Në rast të kundërt, Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
- Mbikqyrësi i punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast, me miratimin e Autoritetit Kontraktor për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast, sipas fajtit, Mbikqyrësi së bashku me Autoritetit Kontraktor dhe Sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Kontraktor për gjendjen e tij. Në rast se Autoriteti Kontraktor ka vërejtje e njofton Sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre.
- Për çdo ndryshim të mundshëm në objekt, Mbikqyrësi i punimeve vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

5.2 Në përfundim të punimeve Mbikqyrësi:

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej Kontraktorit dokumentacionin përkatës.
- Sipas legjislacionit në fuqi dorëzon pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

5.3 Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

- *Proces-verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit*
- *Proces-verbalin për fillimin e punimeve*

- *Kontratën e Sipërmarrjes*
- *Kontratën e Mbikqyrjes*
- *Projekt organizimin e punimeve*
- *Projektin teknik të zbatimit*
- *Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqëruar me korrespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme*
- *Preventivin fitues*
- *Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rinj të punimeve, negocimin e tyre)*
- *Grafikun e punimeve*
- *Specifikimet teknike*
- *Azhornimin para fillimit të punimeve dhe pikeitimi*
- *Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinjerik për punime të paparashikuara*
- *Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme*
- *Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyrësi të shoqëruar me fotografi*
- *Ditarin e objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga Mbikëqyrësi*
- *Librezën e masave*
- *Shkresën e Mbikqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë, shoqëruar me dokumentacionin përkatës*
- *Proçes-verbalin e përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi]*
- *Preventivin e fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi*
- *Situacionin e fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi*
- *Çertifikatat e cilësisë së materialeve*
- *Miratimin e materialeve të përdorura nga Mbikqyrësi*
- *Situacionet pjesore dhe situacioni përfundimtar*
- *Regjistrin e kontabilitetit*
- *Deklaratën teknike të Sipërmarrësit të firmosur nga Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik*
- *Njoftimin e sipërmarrësit për përfundimin e punimeve*
- *Proçes-verbalin e përfundimit të punimeve të firmosur nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi, së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar*
- *Relacionin përfundimtar të Mbikqyrësit*

5.4 I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e Mbikqyrësit. Ky dokumentacion përgatitet e dorëzohet në 3 (tre) kopje.

5.5 Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen pranë grupit të kolaudimit duhet të jenë origjinale.

5.6 Mbikqyrësi i punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos. Pas përfundimit të kolaudimit, Mbikqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në

dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur Sipërmarrësit dhe i jepet për të likuiduar Autoritetit Kontraktor.

6 Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes

6.1 Shërbimi i mbikqyrjes zgjat për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve dhe periudhës së garancisë së punimeve.

6.2 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike
- Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të urdhërojë Mbikqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të legjislacionit në fuqi.

➤ Në veçanti për pikat e mëposhtme do të aplikohen penalitete si më poshtë:

1. Për sa i përket pikës 5.2 të këtyre TORs:

Në përfundim të punimeve Mbikqyrësi:

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej Kontraktorit dokumentacionin përkatës.

Në rast kur Mbikqyrësi nuk arrin të marrë dokumentacionin përkatës brenda këtij afati, për shkaqe që nuk mund ti ngelen Kontraktorit (Sipërmarrësit të punimeve), do të aplikohen dëme të likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve dhe do të llogariten me tarifë ditore 1/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

2. Për sa i përket pikës 5.5 të këtyre TORs:

Sipas legjislacionit në fuqi dorëzon pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij:

- Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet/ caktohet brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen pranë grupit të kolaudimit/ Kolaudatorit duhet të jenë origjinale.

Në rast kur Mbikqyrësi nuk arrin të dorëzojë dokumentacionin përkatës brenda këtij afati, do të aplikohen dëme te likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve dhe do të llogariten me tarifë ditore 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

3. Shërbimi i mbikqyrjes zgjat për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve (sipas objekteve me kohë të plotë të inxhinierit rezidente) dhe periudhës së garancisë së punimeve (kontroll çdo 4 muaj të gjendjes së objektit shoqëruar me raport).

Në rast kur Mbikqyrësi nuk arrin të dorëzojë raportin përkatës për periudhën e garancisë së punimeve, do të aplikohen dëme të likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve dhe do të llogariten me tarifë ditore 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u paguar nga AK.

- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
- **Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.**
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 10.01.2025, ora 10.⁰⁰**, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT